Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Shkelzen Hoxha	**20.10.2023**	**30.10.2023**	**2023/0782**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.10.2023, **OE HARST Group** SH.P.K. Suharekë ka parashtruar ankese me nr. 2023/0782, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve spitalore** me nr. të prokurimit: **70010-23-1324-2-1-1** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI REGJIONAL - PRIZREN. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji kontratës, shërbim, vlerë e madhe, vlera e parashikuar e kontratës: 600,000.00 €

Ankesa është e përsëritur lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. OSHP: 2023/0388 i datës: 27/07/2023. (lënda është kthyer në Rivlerësim).

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05/L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së- Qëllimi;

Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe efikasiteti;

Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;

Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 60 i LPP-se – Kriteret për Dhënien e Kontratës;

Neni 69 i LPP-së – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

Neni 72 I LPP-së -Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;

Neni 38 i RrUOPP.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Të nderuar Autoriteti Kontraktues edhe pas Vendimit të PSH nr. 2023-0388 të OSHP-së, supozojmë që nuk e kan respektuar as vendimin e as LPP-në, kan rekomanduar për kontrat GOE me të shtrejt se ne, i cili GOE është i papërgjegjshëm, po ashtu edhe pse kan kërkuar sqarimet si për mbështetje nga banka, po ashtu edhe për qmimet jo nomalisht të ulëta apo të larta, kan bërë eliminimin e kozerciumit tonë, duke kamufluar faktet dhe duke mos prezantu dëshmit të cilat kemi dorzuar gjatë sqarimeve te komisioni, mirpo kan lëshuar vendim për eliminim tonë pa precizuar se cili qmim nuk është arsyetuar, cili nuk ka qenë i mirëqen, apo cili arsyetim nuk është i qëndrueshëm. Gjithashtu në Vendimin për eliminimin tonë e kan mfshehur që me sqarime e kërkuar nga ana e AK-së, për të jua hequr dilemat ne si kompani kemi dërguar edhe konfirmimin bankar që para hapjes dhe po në atë ditë të hapjes me dt. 14.04.2023 në xhirollogarine e Construmax shpk kan qenë mbi 100 mije euro mjete në llogari ndërsa kërkesa për mbështetje ka qenë për 60 mije euro, ku sqarojm që edhe mbështetjen e bankës e kemi pasur të dorzuar së bashku me ofert, dhe përsëri kemi dërguar sqarim shtesë nga banka që në rast që kemi nevoj për këtë projekt do të na përkrah banka deri 100 mij euro, po ashtu kemi dërguar edhe deklaratat nga bankat që na mbështesin.

Porv: sqarimet- konfirmimi nga banka që me dt.14.04.2023 kem pas 104,673.30 €

Porv: letër përkrahja nga banka e dorzuar me ofertë në vlerë 100,000.00 €

Prov: Sqarim shtesë nga banka– letër përkrahje me të cilën ka sqaruar banka që në rast kërkesës nga Harst Group mund të mbështes me kredi për këtë projekt deri në vlerë 100,000.00 €

Mirëpo në pamundësi për eliminimin tonë, supozojm që udhëheqësi i Zyres së Prokurimit AK duke keqpërdor poziten e tij, duke mfshehur dëshmit komisionit dhe sqarimet e dërguar nga ne, që mendojm që nuk ka të bëjë më një kultur institucional dhe respektim e pozitës dhe detyrave të përcaktuara me ligj. Konsiderojm që ky fakt qëndron për arsye që nuk kanë prezantuar të gjitha dëshmit e sqarimeve komisionit vlerësues edhe për faktin që deri me ditën që kemi bërë kërkesë për rishqyrtim dt.26.09.2023 në e-prokurim nuk janë shkarkuar nga AK, dokumentat të cilat janë dërguar për sqarim në e-prokurim.

Prov. Screen faqës së e-prokurimit ku vërehen që nuk i kan shkarkuar (nuk i ka dy)



Pretendimi 1 Pretendimi 3 - Autoriteti Kontraktues lidhur me arsyetimin për eliminim të konzerciumit tonë lidhur me qmime ab normalisht të ulëta dhe abnormalisht të larta, edhe pse ne kemi bërë sqarime për të gjitha pozicionet veq e veq prejardhjen e qmimit me gjithësejt 66 faqe lidhur me sqarime se si është fituar qmimi duke parsaqitur koston e materialit, koston e fuqis punoter, koston e skeleris, kostone transportit dhe fitimin e parapara, AK na kan eliminuar pa asnjë koment se cili çmimi nuk ka qenë i mirëqen apo cila prejardhje e qmimit nuk është në përputhje me qmimin e tregut. Gjithashtu as që janë shkarkuar nga e prokurimi dëshmit lidhur me arsyetimin e qmimit. Konsiderojm që kërkesa për sqarime të qmimeve ka qenë vetëm sa për të dhënë një arsye për ta shpërfillur Vendimin e PSH, ndërsa nuk është kërkuar sqarime tek GOE i rekomanduar për kontratë ku ka qenë e precizuar ne Vendim të PSH nr 2023-0388 të kërkohet arsyeshmëri e qmimeve për çmime ab normalisht të ulëta që sqaruam në pretendimin 1.– Autoriteti Kontraktues nuk kan zbatuar vendimin e PSH nr.2023-0388 të OSHP-së për arsye që nuk kan kërkuar sqarime për qmime abnormalisht të ulëta kompanis të rekomanduar për kontrat, mirpo ka rekomanduar përsëri GOE të njejtë pa kërkuar sqarime lidhur me qmimet abnormalish të ulëta, citoj konkluzen e ekspertiti dhe PSH nr.2023-0388:

Eksperti shqyrtues sqaron se, AK nuk kishte kërkuar fare sqarime nga OE ankues lidhur me arsyet për çmime ab-normalisht të ulëta apo të larta. Po ashtu AK nuk kishte kërkuar sqarime shtesë as nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë pavarësisht se në disa pozicionet vërehet se oferta e OE të rekomanduar për kontratë përmban çmime jo normalisht të Ulëta, duke e cituar në ketë rast nenin 41.6 të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, sipas të cilit *"Në rast se një tender* (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi*) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët".*

Për arsyet e cituara si më sipër, Paneli krijoj bindjen e tij të pavarur dhe objektive se rekomandimet e ekspertit shqyrtues gjejnë zbatim ashtu sikurse janë dhënë ato në Raportin e ekspertit të datës 19.06.2023. Në fakt, të gjitha pohimet ankimore janë përfshirë në raportin e ekspertit shqyrtues dhe janë analizuar të gjitha dhe në mënyrë specifike secila nga to, pa nevojë që tani (në ketë vendim) të përsëriten dhe/ose përshkruhen në detaje të gjitha ato. Paneli me pavarësinë e plotë profesionale, në mënyrë të pavarur dhe objektive, ka vlerësuar me kujdes të gjitha faktet dhe provat në dispozicion dhe konstaton se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 9, 59, 60, 69, 72 të LPP. Po ashtu AK duhet të mbaj përgjegjësinë e plotë për shkeljet e argumentuara në mënyrë specifike në raport me dispozitat e cituara në ankesë dhe në ekspertizë.

Ky GOE është i papërgjegjshëm për faktin që ka disa qmime manipulative me qmime njësi 1 euro, ku evidentojm vetëm disa nga pozicionet me qmim njësi 1 Euro: Pos 39 Furnizimi dhe Montimi i panelave Alumini. Çmimi per m2 ka ofertuar 1€/m2 Pos 45 Furnizimi dhe Montimi i te derës se Blinduar. Çmimi për copë ka ofruar 1€/copa Pos 6 Furnizimi dhe Montimi I Radiatorit. Çmimi per m2 ka ofertuar 0.55 €/m2

Bazuar në këto çmime të ofertuar nga GOE i rekomanduar jo vetëm që janë ab normalisht të ulëta, por edhe janë Çmime komplet manipulative, pasi që me këto çmime nuk mund të blen 1m2 varak(foli) alumini e mos të flasim Panel Alumini, apo me 1 € nuk mund të blen cilindrin e derës, e mos të flasim komplet derën e Blinduar, apo me 0.55€/m2 nuk mundet të blen një ventil të radiatorit e mos të flasim që mund të blenë 1m2 radiator me 0.55€/m2

Supozojm që AK duke e ditur mirë që GOE ka qmime manipulative abnormalisht të ulëta, nuk ka kërkuar sqarime për Çmime abnromalisht të ulëta tek GOE i rekomanduar, mirpo vetëm kozerciumit tonë, ku për disa pozicione që janë konsideruar të konzerciumi i jonë abnormalish të ulëta, janë shumë më të larta se qmimet po në këto pozicionet te GEO i rekomanduar për kontrat, ku do të sqarojm në pretendimin 3.

Andaj bazuar në ekspertizën nr 2023-0388 dhe Vendimin e PSH nr. 2023-0388, konsiderojm që AK ju ka shmangur konkluzioneve dhe pretendimeve të bazuar për GOE të rekomanduar për kontrat, duke kërkuar sqarime vetëm nga konzerciumi i jone lidhur me qmime abnormalisht të ulëta, duke ju shmangur eliminimin e GOE të rekomanduar pasi që ka pas qmime ultra të ulëta, manipuluese dhe ab normalisht të ulëta.

Pretendimi 2- Autoriteti Kontraktues nuk kan respektuarë vendimin e PSH nr.2023-0388 të OSHP-së edhe për faktin që kompania e cila përsëri është rekomandaur për kontrat është

konsideruar si e papërgjegjshëm për disa pika, andaj veprimi i AK lidhur me vendimi për rekomandim të GOE të njejtë, supozojmë që ka të bëjë me mos përfillje dhe mos respektim të Panelit Shqyrtues të OSHP-së, dhe si i tillë ky vendim lidhur me rekomandim të GOE të njejtë për kontrat është në kundërshtim me LPP-në dhe Vendimin PSH nr. 2023-0388, pasi që GOE i rekomanduar për kontrat nuk ka të prezentuar Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë të certifikuar me AME, mirpo ka të prezentuar Bachelor të diplomuar të ndërtimtarisë që nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Edhe pse AK ka kërkuar sqarime të GOE të rekomanduar për kontrat se të sqarohet evidenca që kanë diplom të masterit për këtë inxhinier, mirpo GOE nuk ka dërguar sqarimet sipas kërkesës dhe pa dërguar prova që ka diplom të Masterit ka potencu kinse është diploma dhe përvoja është sipas DT. Sqarojm kërkesa në DT tek Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 2 pika 2.3 2.3 Nje inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë drejtimi hidroteknike me 5 vite pervoje pune pas diplominimit I qertifikuar ne AME (Agjensioni per menagjimin e emergjencav) dhe te kete trajnim ne sistemin e shendetit dhe sigurise ne pune. Dëshmia e kërkuar dokumentare : Për stafin nga pika 2.2 deri 2.6 OE të ofroj dëshmi kopjen e diplomës universitare të noterizuar nga origjinali (noterizimi të mos jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e njoftimit për kontratë dhe te jete I noterizuar nga vete I angazhuari...)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

6.1)Kapaciteti teknik dhe professional: 2.3 Nje inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë drejtimi hidroteknike me 5 vite pervoje pune pas diplominimit I qertifikuar ne AME (Agjensioni per menagjimin e emergjencav) dhe te kete trajnim ne sistemin e shendetit dhe sigurise ne pune.

Komisioni i Rivlersimit konsideron që nuk është sipas kërkesës pasi që-për këtë pozitë keni prezantuar Z. Edon Halili për të cilin keni prezantuar diplomë të bachelorit , dhe në Cv është evidentuar që ka kryer studimet master në vitin 2022 , pra AK- kërkon sqarime për diplomën e masterit edhe pse sipas CV i njëjti nuk mund të ketë 5 vite përvoj pune pas diplomimit pasi që edhe bachelorin e ka përfunduar në vitin 2017
pyetshtu i mungon kopja e noterizume e Certifikatës së AME, mungon kontrata e noterizume por është prezantu kopje e noterizume , mungon certifikata për siguri dhe shëndet në punë

SQARIM: Sa i përketë ingjinierit të ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik ne kemi prezantuar z. Edon Halili i diplomuar pran Fakultetit të Ndertimtarisë drejtmi Hidroteknik me 20 Korrik 2017. Pra studimet universitare i ka perfunduar ne Departamentin e Ndërtimtarise drejtimi Hidroteknik pikërisht ashtu siq është kërkuar edhe në Dosjen e tenderit.
Kurse sa i përketë periudhës së përvojës ju njoftojmë se z. Edon Halili nga data 20 Korrik 2022 e ka plotësuar këtë kriter (20 Korrik 2018 – 1 Vit, 2019 – 2 vite, 2020 – 3 vite, 2021 – 4 vite dhe 20 Korrik 2022 – 5 vite).

Andaj bazuar edhe në faktin që ky GOE i cili u rekomandua për kontrat, do të duhej eliminuar pasi që nuk ka dërguar diplom të masterit konform kërkesës së DT, po ashtu konsiderojm që ky GOE duhet të futet në listë të zezë për arsye të dhënave të rrejshme në CV e prezentuar të inxhinierit.

Pretendimi 3 - Autoriteti Kontraktues lidhur me arsyetimin për eliminim të konzerciumit tonë lidhur me qmime ab normalisht të ulëta dhe abnormalisht të larta, edhe pse ne kemi bërë sqarime për të gjitha pozicionet veq e veq prejardhjen e qmimit me gjithësejt 66 faqe lidhur me sqarime se si është fituar qmimi duke parsaqitur koston e materialit, koston e fuqis punoter, koston e skeleris, kostone transportit dhe fitimin e parapara, AK na kan eliminuar pa asnjë koment se cili çmimi nuk ka qenë i mirëqen apo cila prejardhje e qmimit nuk është në përputhje me qmimin e tregut. Gjithashtu as që janë shkarkuar nga e prokurimi dëshmit lidhur me arsyetimin e qmimit. Konsiderojm që kërkesa për sqarime të qmimeve ka qenë vetëm sa për të dhënë një arsye për ta shpërfillur Vendimin e PSH, ndërsa nuk është kërkuar sqarime tek GOE i rekomanduar për kontratë ku ka qenë e precizuar ne Vendim të PSH nr

2023-0388 të kërkohet arsyeshmëri e qmimeve për çmime ab normalisht të ulëta që sqaruam në pretendimin 1.

Edhe pse AK në sqarimet e kërkuar ka evidentuar me tepër se gjysmën e paramases kinse disa qmime janë abnormalish të ulëta e disa ka konsideruar të larta, ne kemi sqaruar veq e veq për secilin 66 faqe, po ashtu në këto qmime që janë konsideruar abnormalish të ulta vetë GOE i rekomanduar për kontrat disa nga këto qmime i ka shumë më lirë se oferta janë të cilat janë konsideruar abnormalish të ulëta, si dhe disa pozicione tjera të cilat janë konsideruar shumë të larta për neve, po ashtu GOE i rekomanduar për kontrat i ka shumë më të larta se oferta e jonë.

Prov: Sqarimet e dërguara lidhur me arsyetimin e qmimeve abonormalish të ulëta dt.20.08.2023

Prov: Lista e qmimeve në mes GOE të rekomanduar dhe Ofertës tonë të cilën e kemi dorzuar së bashku me ankesën nr.2023-0388

Pretendimi 4 – Autoriteti Kontraktues lidhur me arsyetimin për eliminimin të konzerciumit tonë lidhur me kinse nuk kemi dëshmi të mjaftueshme për mbështetje nga banka apo nuk kemi mjete në llogari në vlerë 60 mije euro, përpos që nuk është ky pretendim i qëndrueshëm, supozojm që kemi të bëjmë edhe me keqpërdorim të detyrës zyrtare, pasi që ne si kompani kemi pasur të dorzuar me ofert mbështetjen nga banka në vlerë 100 mije euro, po ashtu në sqarimet e kërkuar nga AK kemi dorzuar edhe raport nga banka që me datë 14.04.2023 kemi pasur mjete financiar vetëm në Procredit Bank 104,676.30 euro, po ashtu kemi dërguar edhe letër përkrahje nga banka BKT e cila ka konfirmuar mbështetje nga banka që nuk ka kushtëzime për qasje në kredi deri në vlerë 100 mije euro. Konsiderojm që kjo arsye eliminuese është e pabazuar dhe e pa qëndrueshëm, pasi që konzerciumi jonë ka mjete monetare shumë më tepër se sa janë kërkuar dhe mbështetje bankare mund të kemi deri në 500 mije euro në rast që është e nevojshme.

Porv: sqarimet- konfirmimi nga banka që me dt.14.04.2023 kem pas 104,673.30€

Porv: letër përkrahja nga banka e dorzuar me ofertë në vlerë 100,000.00€

Prov: Sqarim shtesë nga banka– letër përkrahje me të cilën ka sqaruar banka që në rast kërkesës nga Harst Group mund të mbështes me kredi për këtë projekt deri në vlerë 100,000.00.

Pretendimi 5 – Autoriteti Kontraktues po ashtu e kanë kosideruar që OE më i shtrejtë se kompania jonë, si të përgjegjshëm, ku ky OE e ka letër përkrahjen të ngjashme me atë të cilën kemi dorzuar në ofert ku potencohet që në rast kërkese për mbështetje financiare nga banka për këtë projekt, banka do ta shqyrtojë financimin e tij, dhe në këtë rast AK do të duhejt të trajtonte të gjithë Ofertuesit në mënyrë të barabart dhe të mos bëntë diskriminim. Ofertuesi më i liri në këtë tender OE Al...s është i eliminuar dhe është pa interes material pasi që nuk ka paraqitur ankes. Gjitashtu OE më shtrejt se ne – ofertuesi 4 OE Term...m është pa interes material pasi që në Ankesen nr.2023-0388 dhe në kërkesat për rishqyrtim kemi potencuar që është i papërgjegjshëm dhe është pajtuar pasi që nuk ka paraqit kërkes për rishqyrtim dhe është pajtuar, për mangësit që i ka lidhur me staf profesional, për të cilat nuk po zgjerohemi në këtë fazë. Andaj bazuar në ato që cekum më sipër, supozojm që arsyet eliminuese janë të pabazuara lidhur me arsyet eliminuese të kompanis tonë, pasi që janë dhënë sqarimet e nevojshme dhe nuk kemi ndonjë saktësim se cila nuk e plotson, po ashtu AK as që kan qenë të interesuar të

merreni me sqarime pasi që është fakt dëshmia nga e-prokurimi që as që janë shkarkuar nga e-prokurimi dëshmit e dërguar për sqarime. Gjithashtu AK konsideorjm që nuk e kan respektuar Vendimin e PSH nr.2023-0388 dhe për qështje të shyqrtuara nga PSH lidhur me pretendimet tona që GOE i rekomanduar për kontrat është i papërgjegjshëm të cilat pretendime nga PSH janë konsideruar të bazuar, keni rekomanduar për kontrat GOE e njejtë i cili është konsideruar i papërgjegjshëm. Supozojm që AK në pamundësi për eliminimin e kompanis tonë, kan vonuar procesin e rivlersimit, ku kemi dërguar shkresë në OSHP-në për tejkalim të afateve ligjore, duke potencuar që kan vepruar kondërligjshëm duke rekomanduar përsëri GOE të njejtë më të shtrejt se konzerciumi i jonë, duke mos respektuar OSHP-në dhe LPP-në, supozojm për interesa personale që do të kërkojm marrje masave ndaj Menaxherit të Prokurimit nga OSHP-ja dhe shqyrtimin e lëndës në institucione tjera të përcaktuara me ligjë.

Gjithashtu AK nuk e k respektuar nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik në mënyr të pabarabart duke na eliminuar padrejtësisht me evidentime të shumta ta pa bazuara, dhe duke shpallë fitues GOE i cili është më i shtrejt se oferta e jonë dhe është i papërgjegjshëm bazuar edhe në Vendimin të PSH me nr.2023-0388, që kanë qmime jo normalisht të ulëta dhe i papërgjegjshëm, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i AK-së ka qenë që ne mos të shpallemi fitues, duke na eliminuar me disa arsyeje të pabaza eliminuese duke mos respektuar nenin 6 pasi që kemi qenë më qmim më të lirë dhe duke shpallë fitues një kompani me të shtrejtë se ne dhe të papërgjegjshëme në kundërshtim me nenin 59 dhe 60 të LPP-së. Autoritet kontraktues na ka eliminuar në kundërshtim edhe me nenin 68 dhe 69 të LPP-së pasi që kemi plotsuar Gjendjen ekonomike dhe financiare dhe aftesin Teknike/Profesionale.

Nuk kan respektuar edhe nenin 72 të LPP-së e as nenin 38 të RrUOPP, duke na eliminuar për dokumente të dorzuara dhe në rast të paqartësive nuk e kan zbatuar këto nene për sqarimet e lejuara, me qëllimin e eliminimit tonë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i janë përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Gjithashtu autoritet kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga AK që të merr:

V E N D I M APROVOHET, Ankesa e OE "Harst Group sh.p.k. & Construmax sh.p.k. . si e bazuar ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM, DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së dhe ne si GOE të përgjegjshëm dhe me me çmim më të ulët të shpërblehemi me kontratë. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në OSHP.

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi me çmimin me të ulët me poentim

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i rivlerësimit ka rekomanduar për kontratë OE Grup i Operatorëve Ekonomik U - UNIQUE SH.P.K.;EING COM SH.P.K., Rr. Holger Petersen, 10000, Prishtinë me çmimin në vlerë prej: 3858.62 €.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

OSHP, ka nxjerr një vendim për këtë lëndë me numër: OSHP: 2023/0388 i datës: 27/07/2023. (lënda është kthyer në Rivlerësim).

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **HARST Group SH.P.K.**

• **Sqarim hyrës**, Autoriteti Kontraktues (AK), SPITALI REGJIONAL – PRIZREN gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka aplikuar procedurë të hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës shërbim dhe vlera e parashikuar e kontratës është në vlerë prej: 600,000.00 €, AK me datë: 22.09.2023 kishte publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së pas Ri vlerësimit në sistemin elektronik ka rekomanduar për kontratë, OE Grup i Operatorëve Ekonomik U-UNIQUE SH.P.K.; EING COM SH.P.K. Rr. Holger

Petersen, 10000, Prishtine me çmimin prej: 38,858.62 €.

OE "HARST Group SH.P.K" lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve spitalore"** me numër të prokurimit: **70010-23-1324-2-1-1** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI REGJIONAL – PRIZREN nuk është pajuar me kërkesën për rishqyrtim dhe me vendimit e AK –së dhe OE ka paraqitur ankesë në OSHP m datën: 11.10.203.

Vlen të theksohet se kjo lënd është trajtuar nga OSHP me numër të vendimit PSH. Nr OSHP: 2023/0388 i publikuar me datën: 12.06.203.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1. Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nga PSH (OSHP) është nxjerr 1 (një) Vendim me numër: OSHP: 2023/0388 i publikuar me datën: 12.06.203 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektohen dispozitat ligjore, neni 41.6 i Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 sipas të ciles *Në rast se një tender***(apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi)***duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jonormalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët".* Bazuar në neni 16 (Rastet e Unifikuara) pra janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontekstit dhe palët janë të njëjta, për rastet ku janë shqyrtuar më parë si çështje të gjykuara "res judikata" sipas nenit 105.2.16 të LPP –së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues. Gjithë ashtu eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit - ZPP që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP –së.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2. Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nga PSH (OSHP) është nxjerr 1 (një) Vendim me numër: OSHP: 2023/0388 i publikuar me datën: 12.06.203 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektohen dispozitat ligjore, 6, 7, 9, 59, 60, 69, 72 të LPP. Bazuar në neni 16 (Rastet e Unifikuara) pra janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontekstit dhe palët janë të njëjta, për rastet ku janë shqyrtuar më parë si çështje të gjykuara "res judikata" sipas nenit 105.2.16 të LPP –së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues. Gjithë ashtu eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit - ZPP që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP –së.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3. Eksperti Shqyrtues sqaron, duke u bazuar mbi bazën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë sipas vendimit OSHP: 2023/0388 i publikuar me datën: 12.06.203, lidhur me çmime a normalisht apo ab normalisht ulta apo të larta. AK sipas vendimit të larë përmendur, AK duhet të kërkoj sqarime shtesë/arsyeshmëri të çmimeve për dy grupet e operatoreve ekonomik dhe të

respektohen dispozitat ligjore neni 7 i lPP –së Barazia në trajtim /Jo – Diskriminim si dhe neni 41.6 i Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 sipas të ciles *Në rast se një tender***(apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi)***duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jonormalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët".* Bazuar në neni 16 (Rastet e Unifikuara) pra janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontekstit dhe palët janë të njëjta, për rastet ku janë shqyrtuar më parë si çështje të gjykuara "res judikata" sipas nenit 105.2.16 të LPP –së, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues. Gjithë ashtu eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit - ZPP që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP –së.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4 dhe 5. Sipas dosjes së tenderit dhe kërkesës në FDT, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2, **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre vite të fundit financiare duhet te jetë jo më pak se 1,200.000.00 Euro. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme n bankë ose qasje në kredi te pakushtëzuar në vlerë prej së paku 10% e vlerës se parashikuar te buxhetit. ***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare qe dëshmon qarkullimin financiare për tri vitet të fundit. Dokumenti të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar që dëshmon se OE i ka mjetet financiare në dispozicion lidhur për këtë projekt.

Eksperti Shqyrtues sqaron, duke u bazuar mbi bazën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, OE ankues në ofertën e tije fillestare ka dorëzuar Letër mbështetje nga banka BKT dhe me datën: 14.08.2023 ka ofruar një sqarim po ashtu nga banka në fjalë citoj (letrën të lëshuar nga Banka), *" Sqarim: Letër përkrahja e datës 12.04.2023 është format i letër përkrahjeve për produktet e tenderuese publike dhe shqyrtimi i financimit është procedurë e brendshme e bankës" – Dëshirojmë t'ju informojmë se Banka merr në konsideratë me interes të veçantë çdo kërkesë financiare që lidhet me qëllimin e përmendur më lartë.*

Duke u bazuar në letër përkrahjet të cilat i ka lëshuar banka edhe në letrën sqaruese të cilën e ka dhen banka me datën: 14.08.2023 AK ka mundur të kërkoj sqarime nga banka konfomrm nenit 59 pika 2 dhe 72 i LPP –së pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues

që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar "res juridikat" sipas legjislacionit ne fuqi dhe sipas vendimit paraprake të PSH.OSHP Nr. 2023/0388 i dt:12.06.2023 dhe procedura te kthehet ne Rivleresim

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **HARST Group SH.P.K.**

Shkelzen Hoxha